

KOSOVË

INFRASTRUKTURA PËR UJËRA TË ZEZA NË FERIZAJ



PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE (PJT)

Tetor 2023

Shënim: Ky dokument është një përkthim i origjinalit të shkruar në anglisht. Në rast të ndonjë paqartësie apo dyshimi, versioni në gjuhën angleze ka përparësi.

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
MS	Mjedisor dhe Social
PMMS	Plani për Menaxhim Mjedisor dhe Social
PMS	Politika Mjedisore dhe Sociale
BE	Bashkimi Evropian
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PJT	Përmbledhje jo-teknike
OM	Operimi dhe Mirëmbajtja
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
KRUB	Kompania Rajonale e Ujësjellësit Bifurkacioni
PAPI	Plani për Angazhim të Palëve të Interesit
ITUZ	Impiant për Trajtim të Ujërave të Zeza

PËRMBAJTJA

FAQE

1	HYRJE.....	4
2	PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT.....	5
3	NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE.....	6
4	KOMUNIKIMET	8

1 HYRJE

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po shqyrton **ofrimin e financimit për Qeverinë e Kosovës për të financuar modernizimin dhe rindërtimin e infrastrukturës për trajtim të ujërave të zeza dhe të kanalizimeve në Ferizaj** ("Projekti"). Infrastruktura e ujërave të zeza operohet dhe menaxhohet nga subjekti publik Kompania Rajonale e Ujësullës Bifurkacioni ("KRUB" ose "Kompania"). Mangësitë në rrjetet ekzistuese të ujërave të zeza dhe mungesa e shërbimeve të trajtimit të ujërave të zeza kanë rezultuar në ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Prandaj, ekziston nevoja urgjente për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të zeza, çka do të përmirësonte cilësinë e shërbimeve të ujërave të zeza, si dhe cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Në vitin 2014, Bashkimi Evropian (BE) financoi një Studim Fizibiliteti për të vlerësuar nevojat e Ferizajt për trajtimin e ujërave të zeza dhe për të propozuar opsione zhvillimore për zonat urbane dhe peri-urbane. Studimi identifikoi opsionet prioritare zhvillimore për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të ujërave të zeza, si dhe për trajtimin e ujërave të zeza. Në vitin 2023, BERZH-i inicioi **një përditësim të Studimit të Fizibilitetit** dhe një vlerësim mjedisor dhe social (MS) shoqërues të Projektit. Përmbledhja e fushëveprimit të përditësuar të Projektit jepet në kapitullin vijues.

Projekti do të menaxhohet nga një **Njësi e Zbatimit të Projektit (NJZP)** që përbëhet nga përfaqësues të KRUB-së dhe qeverisë qendrore (ministritë relevante).

Projekti është kategorizuar si **Kategoria "B"**¹ sipas Politikës MS (PMS) të BERZH-it (2019).

Projekti është në pajtueshmëri me objektivat zhvillimore afatgjata dhe udhëzimet e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës 2016-2021** për përmirësimin e rrjeteve të grumbullimit të ujërave të zeza dhe ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ) në Ferizaj. Ai është gjithashtu i harmonizuar me **Strategjinë Kombëtare të Kosovës për Ujërat 2017-2036**, e cila përcakton objektivat për përmirësimin e shërbimeve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, duke e rritur kështu cilësinë e ujërave sipërfaqësore.

Në përputhje me **legjislacionin kombëtar mjedisor**, studimi lokal i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) nuk është automatikisht i detyrueshëm pasi që ITUZ-i do të trajtojë ujërat e zeza të më pak se 100,000 përdoruesve. Megjithatë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) do të nxjerrë një opinion nëse nevojitet një VNM.

Projekti është në pajtueshmëri me Direktivën e BE-së për trajtimin e ujërave të zeza urbane, si dhe me teknikat më të mira të disponueshme të BE-së për trajtimin e ujërave, ku përcaktohet se ujërat e zeza urbane që hyjnë në sistemet e grumbullimit që u shërbejnë më shumë se 15,000 personave duhet t'i nënshtrohen trajtimit dytësor përpara se të shkarkohen. Projekti është gjithashtu në pajtueshmëri me udhëzimet e përcaktuara në **Direktivën e BE-së për Ilumin e ujërave të zeza** në lidhje me përdorimin e llumit, duke përfshirë zbatimin e saj në një mënyrë që merr parasysh kërkesat e bimëve për lëndë ushqyese dhe shmang ndotjen e tokës, ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore.

Ky dokument është një Përmbledhje Jo-teknike (PJT) e Vlerësimit MS të Projektit të kryer në vitin 2023. PJT ofron një përmbledhje të projektit në gjuhë jo-teknike që mbulon sfondin dhe përshkrimin e Projektit, kërkesat ligjore, përfitimet dhe ndikimet MS me masat zbutëse të nevojshme për të strukturuar Projektin për të përmbushur kërkesat e BE-së, PMS të BERZH-it (2019), si dhe kërkesat për shpalosje dhe komunikim të Projektit.

¹Sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale (PMS) të BERZH-it, një projekt kategorizohet "B" kur ndikimet e tij të mundshme mjedisore dhe/ose sociale janë zakonisht specifike për lokacionin dhe/ose identifikohen dhe adresohen lehtësisht përmes masave efektive zbutëse.

2 PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT

Projekti do të mbulojë komponentët e mëposhtëm:

1. **Ndërtimi i Impiantit të Trajtitimit të Ujërave të Zeza (ITUZ) Ferizaj Jug** i cili do të trajtojë ujërat e zeza prej *përafërsisht* 90,000 banorëve në Ferizaj dhe fshatrat përreth, duke përfshirë tri fshatra në Kaçanik (Koxhaj, Elezaj, Bajnicë). ITUZ Ferizaj Jug është planifikuar të ndërtohet në tokë të rrafshët bujqësore në Komunën e Kaçanikut, në afërsi të lumit Nerodime. Linja hekurudhore ndërkombëtare Prishtinë-Shkup kalon në afërsi të kufirit të lokacionit të ITUZ-it. Paralelisht me linjën hekurudhore është rruga që lidh Kaçanikun e Vjetër me Ferizajn, si dhe autostrada R-6 që lidh Prishtinën me kufirin e Maqedonisë së Veriut, siç është paraqitur në figurën më poshtë.




Figura 2-1: Lokacioni i propozuar i ITUZ-it Jug dhe i objekteve dhe infrastrukturës përreth

Aktualisht nuk ka furnizim me energji elektrike në lokacionin e ITUZ-it. Furnizimi me energji elektrike është i disponueshëm në një distancë prej *përafërsisht* 500 m nga ITUZ-i. KRUB do të aplikojë tek Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike për vazhdimin e furnizimit me energji elektrike në lokacion.

Aktualisht nuk ka qasje adekuate në lokacionin e ITUZ-it. Janë shqyrtuar tri opsione dhe vendimi përfundimtar do të merret në fazat e mëvonshme të dizajnit të Projektit. Një nga opsionet e propozuara do të kërkojë aprovim nga Autoriteti Hekurudhor “Infracos” për të ndërtuar një vendkalim hekurudhor.

2. **Zgjerimi i kolektorit kryesor ekzistues** nga lokacioni aktual afër fshatit Gërlicë deri në lokacionin e propozuar të ITUZ-it (*rreth* 3 km).
3. **Ndërtimi i një pjese të vogël të rrjetit të ri të ujërave të zeza** që kërkohet për të lidhur kolektorin kryesor me fshatrat Varosh, Grackë, Rakaj, Gërlicë dhe Doganaj (gjithsej më pak se 2 km), si dhe tri fshatra të komunës së Kaçanikut (Koxhaj, Elezaj, Bajnicë) (gjatësia nuk dihet për momentin).
4. **Blerja e pajisjeve** për qëllime të ITUZ-it dhe mirëmbajtjes së rrjetit të ujërave të zeza.

3 NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Përfitimet e projektit. Projekti i propozuar ofron përfitime të rëndësishme, duke përfshirë: (i) përmirësimin e cilësisë së lumenjve dhe ujërave nëntokësore, (ii) uljen e emetimeve të gazrave serrë nëpërmjet trajtimit të ujërave të zeza dhe prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet tretjes anaerobe, (iii) rritjen e kënaqshmërisë së klientëve nëpërmjet lidhjeve të zgjeruara të rrjetit të ujërave të zeza, (iv) përmirësimin e besueshmërisë së shërbimit, (v) uljen e ndotjes së lumit dhe ujërave nëntokësore, (vi) rritjen e kapacitetit për zgjerimin e ardhshëm të rrjetit të ujërave të zeza, dhe (vii) mundësi punësimi gjatë operimit. Veç kësaj, gjatë fazës së ndërtimit, ka mundësi për punësim të përkohshëm për fuqinë punëtore lokale, zhvillim të shkathtësive për punëtorët lokalë, angazhim të mundshëm të nënkontraktorëve lokalë, si dhe mundësi për bizneset lokale.

Më poshtë jepet një përmbledhje e ndikimeve dhe risqeve MS gjatë fazave të para ndërtimit, ndërtimit dhe operimit/mirëmbajtjes (OM), e ndjekur nga masat që duhen ndërmarrë për të zbutur çdo ndikim/risk të tillë.

Para ndërtimit. Informatat e sakta për fushëveprimin e saktë të blerjes së tokës do të jenë në dispozicion vetëm pas zhvillimit të studimit të shpronësimit siç kërkohet me *Ligjin e Kosovës për Shpronësim*. Sipas vlerësimeve fillestare, gjithsej 33 parcela toke në pronësi private në lokacionin e planifikuar të ITUZ-it do të preken nga blerja e përhershme e tokës, por nuk pritet asnjë zhvendosje fizike. Nuk parashikohet që blerja e tokës të jetë e nevojshme për zgjerimin e kolektorit kryesor për shkak të vendosjes së tij të planifikuar përgjatë linjës ekzistuese hekurudhore. Aktualisht, mbetet e paqartë nëse do të nevojitet blerja e tokës për ndërtimin e rrugës për qasje në lokacionin e ITUZ-it apo për zgjatjen e linjës së furnizimit me energji elektrike për lokacionin e ITUZ-it. Gjithashtu, në fazat e ardhshme të dizajnit të detajuar do të përcaktohet edhe traseja e saktë e pjesës së rrjetit të ri të ujërave të zeza që kërkohet për të lidhur kolektorin kryesor me disa fshatra. Fazat e dizajnit të detajuar do të ofrojnë qartësi në këto aspekte. Është zhvilluar Korniza për blerje të tokës dhe rimëkëmbje të mjeteve të jetesës për të udhëhequr zhvillimin e një plani të ardhshëm për blerje të tokës dhe rimëkëmbje të mjeteve të jetesës, i cili do të menaxhojë aktivitetet e blerjes së tokës në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e performancës të BERZH-it.

Ndërtimi. Ndikimet dhe risqet tipike negative, si pluhuri, zhurma dhe derdhjet e mundshme të kimikateve, derivateve të naftës, ujërave të zeza dhe materialeve të tjera të rrezikshme, priten brenda vendpunishteve të ndërtimit. Aktivitetet e ndërtimit do të çojnë gjithashtu në ndryshime të përkohshme të habitatit dhe heqjen e bimësisë. Gjatë fazës së ndërtimit, do të gjenerohen lloje të ndryshme mbetjesh, duke përfshirë: materiale të gërmimit, mbetje ndërtimore, mbetje të demolimit, si dhe mbetje të rrezikshme dhe komunale. Menaxhimi efektiv i këtyre mbetjeve do të shmangë ndotjen e ujit dhe tokës në vendpunishtet e ndërtimit. Ekzistojnë disa risqe të mundshme për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve, duke përfshirë punën pranë linjës hekurudhore, ekspozimin ndaj makinerive të rënda, riskun e rënies, rreziqet nga gërmimet dhe aksidentet e automjeteve. Ndikimet negative por të përkohshme për komunitetet lokale lidhen me gjenerimin e pluhurit, emetimet e gazrave të shkarkimit nga makineritë dhe nivelet e rritura të zhurmës. Qasja e paautorizuar në vendpunishtet e ndërtimit mund të çojë gjithashtu në çështje sigurie për popullatën lokale për shkak të ekspozimit ndaj rreziqeve të ndërtimit. Trafiku dhe siguria rrugore në rrugët lokale (veçanërisht për çdo receptor të ndjeshëm) mund të preken përkohësisht. Megjithatë, bazuar në mjedisin kryesisht rural të zonës së Projektit me dendësi më të ulët të popullsisë dhe natyrën e aktiviteteve të planifikuara, ndikimet e parashikuara në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit nuk priten të jenë të rëndësishme. Potenciali për risqet e DHNBGJ (dhunë dhe ngacmim në baza gjinore) është vlerësuar si i ulët pasi nuk janë identifikuar faktorë të rëndësishëm risku që do të rrisnin potencialin për DHNBGJ, si fluksi në shkallë të gjerë i punëtorëve meshkuj kalimtarë, nevoja për punëtorë migrantë, lokacione të largëta me persona që kanë qasje të kufizuar në burimet për të raportuar DHNBGJ, etj.

OM. Gjatë fazës OM priten ndikime tipike negative, duke përfshirë gjenerimin dhe trajtimin e papërshtatshëm të llumit, dëmtime në rrjetin e ujërave të zeza, si dhe dëmtime të pajisjeve mekanike dhe elektrike ose dështime të procesit. Punëtorët mund të përballen me rreziqe që lidhen me trajtimin e kimikateve, ekspozimin ndaj rreziqeve biologjike dhe patogjenëve të ujërave të zeza, si dhe

operacionet e makinerive. Për më tepër, ndikimet e mundshme negative për komunitetet lokale përfshijnë kutërbimin nga proceset e trajtimit të ujërave të zeza dhe llumit, si dhe rrjedhjet ose derdhjet e mundshme nga infrastruktura e vjetëruar apo e papërshtatshme e rrjetit të ujërave të zeza, duke çuar në hyrjen e ujërave të zeza të patrajtuara në mjedis dhe duke ndikuar potencialisht në shëndetin e komunitetit.

Nuk priten **ndikime kumulative**, pasi që nuk ka zhvillime të rëndësishme aktuale apo të planifikuara pranë lokacionit të ITUZ-it që mund të çojnë në ndikime kumulative.

Ndikimet negative MS të identifikuar janë specifike për lokacionin dhe mund të shmangen, reduktohen ose korrigjohen në mënyrë efektive nëpërmjet zbatimit të **masave zbutëse** të përshkruara në Planin për Menaxhim Mjedisor dhe Social të Projektit (PMMS) dhe Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS). Kontraktorit do t'i kërkohet të përgatisë dhe zbatojë një Plan për Menaxhim Mjedisor dhe Social të Ndërtimit (PMMSN), ndërsa KRUB do të jetë përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e një Plani për Menaxhim Mjedisor dhe Social të Operacioneve (PMMSO), të cilat të dy do të bazohen në PMMS-në e zhvilluar. NJZP-ja do të mbikëqyrë zbatimin e masave të specifikuar zbutëse.

4 KOMUNIKIMET

Është zhvilluar një **Plan për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI)** për të identifikuar palët përkatëse të interesit, për të përcaktuar metodat dhe objektivat e angazhimit të palëve të interesit, si dhe për të krijuar një mekanizëm për ankesa specifik për projektin.

NJZP-ja do t'i shpallë këto PJT, PAPI, Formularin për Ankesave të Projektit dhe Kornizën për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës, sa më shpejt që të jetë e mundur në procesin e zhvillimit të Projektit. Dokumentet do të jenë të disponueshme publikisht në shqip, serbisht dhe anglisht **në formë elektronike dhe të shtypur në:**

Emri i institucionit	Ueb faqja	Adresa
KRUB	http://www.bifurkacioni.com/	Rr. Enver Topalli, Ferizaj, Kosovë Tel. +383 (0)290 320 650 info@bifurkacioni.com
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	https://mmphi.rks-gov.net/	Ish "Rilindja", 10000 Prishtinë, Prishtinë, Kosovë Tel. +383 (0) 38 200 32 003 dkp.mmphi@rks-gov.net
Komuna e Ferizajt	https://kk.rks-gov.net/ferizaj/	Rr. Dëshmorët e Kombit, p.n., Ferizaj, Kosovë Tel. +383 (0)38 200 46 076 & 080011005 info.ferizaj@rks-gov.net
Komuna e Kaçanikut	https://kk.rks-gov.net/kacanik/	Rr. Emin Duraku, Kaçanik, Kosovë Tel. +383 290 380 047 & 080011014

Pas shpalljes së dokumenteve të listuara më lart, NJZP-ja do të mbajë **takime konsultative publike** si më poshtë:

- të paktën një grup të takimeve pas përzgjedhjes së dizajnerit të projektit dhe fillimit të zhvillimit të Dizajnit Kryesor - për t'ua prezantuar Projektin palëve të interesit me qëllim të marrjes së reagimeve nga palët lokale të interesit,
- të paktën një grup të takimeve përpara fillimit të ndërtimit – për t'ua paraqitur detajet e projektit të përcaktuara në Dizajnin Kryesor të gjitha palëve të interesit dhe për të marrë reagime nga palët lokale të interesit.

NJZP-ja do t'i informojë 10 ditë përpara të gjitha palët e interesit për datën, orën dhe vendin e saktë ku do të mbahen takimet, përmes kanaleve të listuara në PAPI. Një raport i shkurtër për komentet/propozimet e pranuar dhe përgjigjet nga NJZP-ja do të publikohet në ueb faqet e KRUB, MMPHI, Komunës së Ferizajt dhe Komunës së Kaçanikut.

NJZP-ja gjithashtu do të ofrojë **informacion për punimet e planifikuara të ndërtimit**. Kjo përfshin specifikat në lidhje me lokacionet, datën e parashikuar të fillimit, kohëzgjatjen e pritshme të punimeve të planifikuara dhe çdo ndërprerje të parashikuar në flukset e trafikut dhe çdo shqetësim tjetër të mundshëm për publikun, të paktën 30 ditë përpara fillimit të punimeve, përmes kanaleve të listuara në PAPI.

Gjatë fazës OM të Projektit, **përmbledhjet e Raporteve MS do të publikohen rregullisht** në ueb faqen e KRUB.

Është vendosur **një mekanizëm për ankesa specifik për projektin** për pranimin, vlerësimin dhe adresimin e ankesave nga komunitetet e prekura. NJZP-ja do të zbatojë mekanizmin për ankesa për të siguruar që ai të përgjigjet ndaj çdo shqetësimi dhe ankese, veçanërisht nga komunitetet e prekura. Shpjegimi i detajuar i mekanizmit jepet në PAPI.

Informacione të kontaktit për dërgim të ankesave:

<p>PROJEKTI PËR INFRASTRUKTURË TË UJËRAVE TË ZEZA NË FERIZAJ Njësia e Zbatimit të Projektit Rr. Enver Topalli, Ferizaj, Kosovë Tel. +383 (0)290 320 650 E-mail: info@bifurkacioni.com</p>
--